REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Nr. 6209 Prot. Tiranë, më 02 / 11 / 2026

Lënda: Kërkesë për thirrjen e një mbledhjeje urgjente të Grupit të deputetëve "Miqtë të Fëmijëve" për mbrojtjen e të drejtave të të miturve gjatë protestave dhe shqyrtimin e masave të reja të qeverisë.

Drejtuar: **Z. Niko Peleshi**
Kryetar i Kuvendit
Kryetar i Grupit "Miqtë e Fëmijëve"

I nderuar z. Kryetar,

Në cilësinë e nënkryetares së grupi "Miqtë e Fëmijëve" shpreh shqetësimin tim të thellë për situatën e krijuar në vend lidhur me trajtimin e të miturve gjatë protestave të ditëve të fundit, raportimet për ushtrim dhune ndaj tyre nga punonjës të Policisë së Shtetit, si dhe pasojat që mund të sjellin masat e reja të miratuara nga qeveria për pjesëmarrësit në tubime.

Sipas deklarimeve publike të Ministrit të Punëve të Brendshme, deri më 30 tetor 2026 janë shoqëruar në polici 269 persona nën moshën 18 vjeç gjatë protestave. Kjo shifër është tejet shqetësuese dhe kërkon vëmendje të menjëhershme institucionale, jo vetëm mënyrën brutale që janë menaxhuar protestat nga policia e shtetit duke prekur edhe të miturit, por veçanërisht për mënyrën se si janë trajtuar nga autoritetet shtetërore gjatë shoqërimit, mbajtjes në komisariat dhe gjithë procedurave të tjera.

Pavarësisht qëndrimit që mund të mbajë secili për zhvillimet politike dhe protestat, mbrojtja e fëmijëve, siguria e tyre fizike dhe psikologjike, si dhe respektimi i të drejtave të tyre themelore duhet të jenë përtej çdo ndarjeje politike. Asnjë rrethanë nuk mund të justifikojë dhunën e paligjshme ndaj një të mituri apo cenimin e garancive që legjislacioni shqiptar dhe konventat ndërkombëtare i njohin atij.

Shqetësimi bëhet edhe më serioz në dritën e konstatimeve paraprake të bëra publike nga institucioni i Avokatit të Popullit, pas monitorimit të trajtimit të personave të shoqëruar, arrestuar ose ndaluar gjatë protestave. Në këto konstatime janë evidentuar problematika që lidhen me dokumentimin e procedurave, regjistrimin e të miturve, informimin mbi të drejtat, aksesin në ndihmën ligjore dhe pretendimet për përdorim të dhunës gjatë ndërhyrjeve policore.

Gjithashtu, organizatat që mbrojnë të drejtat e fëmijëve kanë ngritur shqetësime publike për raportimet e prindërve dhe të mediave mbi dhunën dhe intimidimin e të miturve gjatë protestave. Këto raportime kërkojnë verifikim të plotë, objektiv dhe të pavarur, me qëllim që çdo shkelje e mundshme të hetohet dhe çdo përgjegjësi të individualizohet.

Në këtë kontekst, konsideroj se heshtja ose mungesa e reagimit nga një strukturë parlamentare e krijuar pikërisht për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat e fëmijëve do të ishte e papranueshme.

Gjithashtu një shqetësim i veçantë lidhet edhe me paketën e re të masave të qeverisë për protestat, përfshirë aktin normativ që ndryshon ligjin për tubimet dhe parashikimet për përgjegjësinë financiare të prindërve ose kujdestarëve në rastet e dëmeve të shkaktuara nga të miturit, si dhe masat administrative ndaj pjesëmarrësve në tubime të dhunshme.

Vlerësoj se këto masa duhet të shqyrtohen me kujdes të posaçëm nga këndvështrimi i të drejtave të fëmijëve dhe pse dukshëm janë antikushtetuese. Çdo dispozitë që prek të miturit duhet të jetë në përputhje me parimin e interesit më të lartë të fëmijës, individualizimin e përgjegjësisë, proporcionalitetin e masave dhe garancitë për një proces të rregullt ligjor.

Në veçanti, duhet të shqyrtohet nëse parashikimet e reja sigurojnë mbrojtjen e duhur të të miturve, nëse shmangin përgjegjësinë automatike ose joproporcionale të familjeve dhe nëse garantojnë që asnjë fëmijë të mos trajtohet si përgjegjës vetëm për shkak të pranisë në një protestë, pa u vlerësuar individualisht sjellja dhe rrethanat konkrete.

Standardet evropiane dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve janë të qarta:

Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës, në nenin 3, përcakton se interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata parësore në të gjitha veprimet që lidhen me të. Nenet 12 dhe 37 garantojnë të drejtën e fëmijës për t'u dëgjuar, mbrojtjen nga trajtimi çnjerëzor ose poshtërues dhe kufizimin e privimit nga liria në masën e fundit dhe për kohën më të shkurtër të përshtatshme. Neni 40 përcakton garanci të posaçme për fëmijët që përfshihen në procedura të drejtësisë penale.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, veçanërisht nenet 3, 5, 8 dhe 11, kërkon mbrojtjen nga trajtimi çnjerëzor ose poshtërues, ndalimin arbitrar, respektimin e jetës private dhe garantimin e lirisë së tubimit paqësor. Çdo ndërhyrje e autoriteteve duhet të ketë bazë ligjore dhe të jetë e nevojshme e proporcionale.

Standardet e Këshillit të Evropës për policimin e protestave, të riafirmuara nga Komisioneri për të Drejtat e Njeriut në deklaratën e datës 23 tetor 2026, kërkojnë që forca të përdoret vetëm kur është rreptësisht e nevojshme, që pretendimet për tejkalim të saj të hetohen pa vonesë dhe që fëmijëve t'u kushtohet vëmendje e posaçme për shkak të moshës dhe cenueshmërisë së tyre. Privimi i fëmijëve nga liria duhet të jetë masë e fundit, me garantimin e aksesit në ndihmë ligjore.

Këto standarde nuk e përjashtojnë përgjegjësinë individuale kur provohen veprime të paligjshme. Përkundrazi, ato kërkojnë që çdo rast të trajtohet mbi bazën e provave dhe

procedurave ligjore, pa ndëshkime kolektive, pa përdorim joproporcional të forcës dhe pa cenuar të drejtat e fëmijëve.

Për sa më sipër, kërkoj thirrjen urgjente të Grupit Parlamentar të Miqve të Fëmijëve, me një rend dite të posaçëm për shqyrtimin e kësaj situate dhe me pjesëmarrjen e institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Në këtë mbledhje propozoj të ftohen përfaqësues të Avokatit të Popullit, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Policisë së Shtetit, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Arsimit dhe organizatave të specializuara në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Mbledhja duhet të trajtojë në mënyrë konkrete:

1. Të dhënat e plota mbi 269 të miturit e shoqëruar në polici, duke sqaruar rrethanat, bazën ligjore, kohëzgjatjen e shoqërimit dhe mënyrën e trajtimit të secilit rast, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Raportimet për dhunë fizike dhe psikologjike ndaj të miturve, përfshirë rastet e pretenduara të përdorimit të forcës gjatë shoqërimit dhe në ambientet e policisë, si dhe masat e marra për verifikimin e tyre.

3. Respektimin e garancive procedurale për të miturit, përfshirë njoftimin e prindit ose kujdestarit, informimin mbi të drejtat, aksesin në ndihmë ligjore, praninë e psikologut kur kërkohet nga ligji dhe mbajtjen e regjistrave të veçantë.

4. Shqyrtimin e aktit normativ dhe të paketës së re të masave për protestat, për të vlerësuar përputhshmërinë e dispozitave që prekin të miturit me Konventën për të Drejtat e Fëmijës, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e fëmijëve e drejtësinë penale për të miturit.

5. Vlerësimin e ndikimit të masave të reja te familjet dhe fëmijët, veçanërisht të parashikimeve për përgjegjësinë financiare të prindërve ose kujdestarëve, duke garantuar që çdo përgjegjësi të përcaktohet në bazë të ligjit, provave dhe rrethanave konkrete të secilit rast.

6. Marrjen e masave për parandalimin e përsëritjes së rasteve të ngjashme, përmes protokolleve të qarta për ndërhyrjet policore ku përfshihen të mitur, trajnimit të punonjësve të policisë dhe forcimit të mekanizmave të pavarur të monitorimit.

7. Përcaktimin e rekomandimeve dhe të një plani institucional veprimi, me afate konkrete për ndjekjen e problematikave të evidentuara dhe raportimin e rezultateve pranë Grupit Parlamentar të Miqve të Fëmijëve.

Duke pasur parasysh numrin e lartë të të miturve të përfshirë, seriozitetin e raportimeve të bëra publike dhe miratimin e masave të reja me ndikim të drejtpërdrejtë në ushtrimin e të drejtave themelore, vlerësoj se kjo çështje nuk mund të trajtohet si një debat i zakonshëm politik apo të shtyhet për një moment të mëvonshëm.

Grupi Parlamentar i Miqve të Fëmijëve duhet të ushtrojë menjëherë rolin e tij mbikëqyrës dhe mbrojtës, duke kërkuar transparencë, llogaridhënie dhe garanci që çdo fëmijë të trajtohet me dinjitet dhe në përputhje me ligjin.

Mbrojtja e fëmijëve nuk mund të jetë selektive dhe as të kushtëzohet nga bindjet politike të tyre apo të familjeve të tyre. Asnjë fëmijë nuk duhet të bëhet objekt dhune, intimidimi apo ndëshkimi arbitrar. Po kështu, çdo raportim për shkelje të ligjit nga cilido person duhet të shqyrtohet në mënyrë individuale, të paanshme dhe me respektimin e plotë të garancive ligjore.

Për këto arsye, kërkoj që mbledhja të thirret me urgjencë, në një afat sa më të shkurtër, dhe që institucionet përkatëse të ftohen të paraqesin të dhënat, shpjegimet dhe masat konkrete të marra për mbrojtjen e të miturve.

Me respekt,

INA ZHUPA

NËNKRYETARE GRUPI "MIQTË E FËMIJËVE"